

Funksioni i Drejtorit:

1. Drejtori i Drejtorisë emërohet, lirohet dhe/ose shkarkohet nga detyra, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Bazuar në Vendimin nr.173, datë 07.03.2003 *“Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit”*, drejtori emërohet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, urdhëron të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë;
 - b) kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për t’u punësuar referuar Kodit të Punës duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë;
 - c) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore përzgjedh dhe emëron njërin nga kandidaturat e paraqitura që plotëson kërkesat e mësipërme.
3. Drejtor emërohet personi që ka arsim të lartë në një fushë të përshtatshme me funksionin si Drejtor i DRTK Gjirokastër dhe për ushtrimin e kompetencave të DRTK Gjirokastër. Drejtori i DRTK Gjirokastër me detyrat si më poshtë vijon:
4. Drejtori i Drejtorisë ka këto përgjegjësi kryesore:
 - a) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
 - b) harton në bashkëpunim me sektorët dhe zbaton objektivat dhe planin e punës të DRTK Gjirokastër, në përputhje me misionin e saj dhe me politikën, strategjinë dhe objektivat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - c) drejton veprimtarinë dhe praktikën administrative të institucionit dhe përfaqëson DRTK Gjirokastër në marrëdhënie me të tretët;
 - d) mbikëqyr dhe menaxhon efektivitetin e punonjësve dhe burimeve njerëzore;
 - e) bashkërendon proceset e punës të sektorëve dhe orienton veprimtarinë kualifikuese me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të personelit të DRTK Gjirokastër;
 - f) emëron dhe shkarkon nga detyra punonjësit e institucionit në përputhje me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
 - g) nënshkruan marrëveshje me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja, pas miratimit në parim, të ministries përgjegjëse për trashëgiminë kulturore që synojnë bashkëpunim të ndërsjellët, projektet dhe aktivitete të përbashkëta si dhe shkëmbime dhe kualifikime të personelit;